

VENDIM

PANELI NR. 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/A/22/2008
DATA E VENDIMIT: 28/08/2008

URDHËR

- 1) Në secilën nga 1,997 (një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar, apo të pjesës së tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

- 2) Në secilën nga 785 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) kërkesat e regjistruara në pjesën E të listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar pronësinë e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, apo të pjesës së tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

- 3) Në secilën nga 2,782 (dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesat të cilat përmenden në paragrafët (1) dhe (2) të mësipërm, përveç Kërkesave Nr. 34015, 45279, 21960, 21965, 47905, 47907 dhe 21891, Komisioni

urdhëron që

- (a) *Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;*

(b) Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse apo çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën dështon të përmbush urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona;

4) Në secilën kërkesë të regjistruar në pjesën F të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të refuzohen për aq sa paraqitësit e kërkesës kërkojnë kompensim për dëmtim fizik, apo humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar; dhe

5) Në rastet në të cilat ka më shumë se një pronar, vendimet e mësipërme dhe urdhri nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit nga bashkë-pronarët përkatës.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke e miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili adopton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton UNMIK/REG/2006/50. Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I ka themeluar Agjencinë Kosovare të Pronës ("KPA") si agjenci të pavarur sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës, dhe ka ndryshuar dispozitat përkatëse të UNMIK/REG/2006/50 dhe UNMIK/ADM/DIR/2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me kriteret e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Sipas Nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-079, i cili ka ndryshuar nenin 7.1 të UNMIK/REG/2006/50, Komisioni për Kërkesa Pronësore ("Komisioni") duhet të emërohet nga Kuvendi me nominimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme, me kusht që deri në përfundim të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Statusin e Kosovës të datës 26 mars 2007, dy nga tre anëtarët, përfshirë Kryetarin, duhet të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

3. Më 18 qershor 2008, Komisioni i ka dërguar letër Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë duke cekur se, si ai e kupton këtë, synimi i Nenit 10 dhe dispozitave tjera relevante të Ligjit Nr. 03/L-079 nuk ishte t'i shkarkojë anëtarët aktual të Komisionit nga mandati i tyre dhe që, rrjedhimisht, vazhdimi i emërimit të tyre nga Përfaqësuesi Special i datës 22 prill 2008 vazhdon të jetë valid, pos nëse nuk përfundohet më herët në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm. Rrjedhimisht, Komisioni është këshilluar nga Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar që procedurat mbi emërimet e reja të dhëna në Nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-079 nuk ndikojnë në autoritetin e Komisionit që në përbërjen e tij të ushtrojë funksionin e vet. Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar ka konfirmuar se Neni 10 vetëm ofron një procedurë të re për emërimet përkitazi me emërimet e anëtarëve të Komisionit në të ardhmen.

4. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konsideron se është i caktuar sipas rregullave dhe është kompetent të ushtrojë funksionin e vet sipas UNMIK/REG/2006/50 dhe Ligjit Nr. 03/L-079, dhe urdhëresat dhe legjislacionin relevant për zbatim, përfshirë UNMIK/ADM/DIR/2007/5 dhe Aneksin I, respektivisht.

ARSYET PËR VENDIMIN

5. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i të drejtës së ndarjes, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

në rastet ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i të drejtës së ndarjes, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejtë të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

6. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet të zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia në mënyrë të kënaqshme dhe paraqitësi i kërkesës nuk tregon të kundërtën, të japë urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të të drejtës së ndarjes, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë mbi të drejtën e shfrytëzimit në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë të shpejtuar dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, lexo së bashku me nenin 9 të Nën-Aneksin III të Aneksit I.)¹

7. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të tetë më 25-28 gusht 2008 në Prishtinë. Totali prej 2,891 kërkesave për prona bujqësore i ishin paraqitur Komisionit në seancën e tij të tetë, nga Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës (“Sekretaria” dhe “KPA”, respektivisht), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante.

¹ Duket që në Aneksin I të ketë gabim teknik në atë që gjersa Aneksi I qartësisht duket se është menduar të zëvendësojë në tërësi UNMIK/ADM/DIR/2007/5, përfshirë të tri anekset e saj, Neni 26 i Aneksit I në mënyrë të ngatërruar parasheh që e drejta nga Aneksi III i UNMIK/ADM/DIR/2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila i referohet Aneksit II. Aty nuk ka asnjë dispozitë të veçantë dhe as ndonjë indikacion tjetër në Ligjin Nr. 03/L-079 apo në Anekset e tij që qëllimi i këtij ndryshimi specifik ishte të fshijë Aneksin I dhe Aneksin II të UNMIK/ADM/DIR/2007/5. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron se që të tri anekset e UNMIK/ADM/DIR/2007/5 janë të përfshira në pakon legjislative dhe Komisioni në vendimet e tij do t’u referohet atyre si Nën-Anekset I, II dhe III, respektivisht.

8. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuere të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi

9. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësi, dhe të gjitha ishin përkitazi me pronën bujqësore, përfshirë tokë bujqësore, kullosa dhe pyje. Bazuar në shqyrtimet e veta të kërkesave dhe të dokumenteve mbështetëse, dhe të informacioneve të ofruara dhe të verifikimit të bërë nga Sekretaria Ekzekutive, totali prej 109 kërkesave i janë kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për rishikim dhe verifikim shtesë, apo janë tërhequr nga Sekretaria Ekzekutive. Këto kërkesa, të cilat janë të regjistruara në pjesën G të listës së bashkangjitur, do të shqyrtohen nga Komisioni në kohën e duhur. Vendimi aktual aplikohet për 2,782 kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkangjitur.

10. Komisioni cek se të gjitha kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm të pronave, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person apo, edhe ku ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30-ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 10.2 të Ligjit Nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur se Sekretaria Ekzekutive ka bërë orvatje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, personat të cilët aktualisht mund të kenë uzurpuar pronat, dhe të çdo personi tjetër të cilët kanë mundur të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohej nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

11. Në kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur, Komisioni cek se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave të tyre për pronësinë, përfshirë fletat poseduese, kontratat mbi shitblerjen, kontratat mbi dhurimin, kontratat mbi ndarjen e pasurisë, vendimet mbi trashëgiminë, vendimet e gjykatës mbi njohjen e pronësisë, kontratat mbi përkujdesjen jetësore dhe certifikatat për të drejtat mbi pronën e patundshme. Komisioni është i kënaqur se këto dokumente me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Shumë paraqitës të kërkesave gjithashtu kanë paraqitur dokumente mbështetëse shtesë, përfshirë vendimet mbi tatimin, deklaratat e dëshmitarëve, kopjet e planeve dhe vendimet kadastrale. Të gjitha këto dokumente janë vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive si valide, relevante.

12. Në 1,270 kërkesat e regjistruara në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Duke pasur parasysh konstatimet e Komisionit në paragrafin 11 të mësipërm, të gjitha këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen. Në Kërkesat Nr. 41417, 41419, 41420, 41422 dhe 41423 prona e kërkuar është rrugë private. Ndonëse kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e kërkesave të Paraqitësve të kërkesave, apo në të drejtën ligjore të mundshme për ata, ka mundësi që natyra e pronës duhet të merret në konsideratë nga Sekretaria Ekzekutive kur të ekzekutojë vendimin e Komisionit mbi dëbimin, ashtu siç është e përshtatshme.

13. Në 447 kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur, Paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në pajtim me nenin 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Udhëzimit Administrativ dhe neni 1 i Ligjit Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshortin/en, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martese apo të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm, apo personat të cilët janë të obliguar të mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm, pavarësisht nëse ata persona kanë apo nuk kanë qëndruar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, me ligjin të aplikueshëm, ky definicion përfshinë përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve, gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipërit/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave në kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur përfshihen në definicion e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet në secilën kërkesë të regjistruar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e regjistruara në shtyllën 7 të kësaj pjese B të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës pohon se bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur por nuk është paraqitur dëshmi nga paraqitësi i kërkesës e cila do ta dëshmonte vdekjen, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore gjithashtu qëndron të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër. Në Kërkesat nr. 07905 dhe 07908 Paraqitësi i kërkesës ka vdekur pas paraqitjes së kërkesës. Komisioni konsideron se vdekja e paraqitësit të kërkesës gjatë procedurës nuk mund të ndikojë në vlefshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Ky vendim është pa paragjykim ndaj përcaktimit nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri.

14. Në trembëdhjetë kërkesat e regjistruara në pjesën C të listës së bashkëngjitur, bartësit e të drejtës pronësore janë përfaqësuar nga personat e autorizuar fizik të cilët posedojnë autorizim. Komisioni ka përcaktuar se në secilën nga këto raste, personi i autorizuar fizik posedon autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm sipas nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore në secilën nga këto kërkesa qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër.

15. Në 267 kërkesat e regjistruara në pjesën D të listës së bashkëngjitur, Paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i të drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në ditën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por ka ofruar dëshmi që më vonë të ketë trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë përmes trashëgimisë apo kontratës mbi dhurimin, siç mund të jetë rasti. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i të drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, duhet të konsiderohet si person i cili ka trashëguar të gjitha të drejtat që i takojnë një pronari, përfshirë të drejtën për të kërkuar konfirmimin e pronësisë dhe për riposedit në procedurat aktuale. Prandaj, këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen, siç është dhënë më sipër. Në Kërkesën nr. 39673, Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dëshmi që më vonë të ketë trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë përmes vendimit mbi trashëgimin të lëshuar nga gjykata komunale në territorin e së cilës kishte jetuar bartësja e së drejtës pronësore para vdekjes së saj, që dëshmon se Paraqitësi i kërkesës ka trashëguar pronën në fjalë. Komisioni më herët kishte përcaktuar se gjykata në rrethana të tilla ka pasur jurisdiksion të lëshojë vendim (Shih vendimin e Komisionit KPCC/D/A/5/2007 të datës 19 dhjetor 2007.) Në Kërkesën nr. 35957,

Paraqitësi i kërkesës ka vdekur pas paraqitjes së kërkesës. Siç është cekur më lartë, Komisioni konsideron se vdekja e Paraqitësit të kërkesës gjatë procedurës nuk mund të ndikojë në vlefshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, vendimi mbi konfirmimin e të drejtës pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Ky vendim është pa paragjykim ndaj përcaktimit nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Në kërkesat e regjistruara në shtyllën 5 të kësaj pjese D të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesës kanë paraqitur kërkesat në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare apo si përfaqësues të autorizuar të bartësit të së drejtës pronësore, të cilët kanë ofruar dëshmi të kenë trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë përmes trashëgimisë pas ditës së humbjes së posedimit të pronës së kërkuar. Komisioni përcakton se Paraqitësit e kërkesave në këto raste janë anëtarë të bashkësisë familjare të bartësit aktual të së drejtës pronësore në kuptim të nenit 1.2 të Aneks II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 apo posedojnë autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm sipas nenit 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, dhe prandaj kanë të drejtë të paraqesin kërkesë në emër të bartësit aktual të së drejtës pronësore.

16. Në 785 kërkesat e regjistruara në pjesën E të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në ditën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të ketë trashëguar pronën. Në secilën nga këto kërkesa, paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se ai apo ajo është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur vendim valid mbi trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuar nga paraqitësit e kërkesave i cili do të vërtetonte se ndonjëri nga paraqitësit e kërkesave të jetë trashëgimtar i pronës së kërkuar, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Komisioni nuk ka jurisdiksion të zgjidhë çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore në secilën nga këto kërkesa qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Vendimi i Komisionit sa i përket të gjitha kërkesave të regjistruara në pjesën E të listës së bashkëngjitur është pa paragjykim ndaj përcaktimit nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Në Kërkesën nr. 08183, Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin mbi trashëgiminë për të dëshmuar se Paraqitësi i kërkesës është trashëgimtar i pronës së kërkuar. Megjithatë, ky vendim nuk mund të konsiderohet valid pasi që gjykata e cila e ka lëshuar vendimin nuk ishte gjykata në territorin e së cilës gjendej prona dhe as në territorin e së cilës kishte jetuar bartësi i së drejtës pronësore para vdekjes së tij. Në Kërkesën nr. 27809, Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kontratën mbi përkujdesjen jetësore në mbështetje të pronësisë së tij mbi pronën e kërkuar. Megjithatë, dëshmitë në dosje të lëndës tregojnë se vlefshmëria e kontratës është kontestuese. Në këto rrethana, Komisioni është i gatshëm të marrë vendim vetëm mbi konfirmimin e të drejtës pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore, siç është dhënë më sipër. Në Kërkesën nr. 43081, Paraqitësi i kërkesës ka vdekur pasi ka paraqitur kërkesën. Siç është theksuar më sipër, Komisioni konsideron se vdekja e paraqitësit të kërkesës gjatë procedurës nuk ndikon në vlefshmërinë e kërkesës. Në Kërkesën nr. 22613, Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kontratën mbi dhurimin që konfirmon pronësinë, e cila ishte vërtetuar në gjykatën kompetente, por nuk ishte regjistruar në të dhënat publike mbi pronën në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Komisioni më herët kishte konstatuar se një kontratë e tillë përbën dëshmi të mjaftueshme mbi pronësinë. (Shih, p.sh. vendimin e Komisionit KPCC/D/A/19/2007 të datës 20 qershor 2008.) Rrjedhimisht, vendimi mbi konfirmimin e të drejtës pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Vendimi i Komisionit në këtë çështje paraqet mendimin e shumicës së anëtarëve të Komisionit. Në kërkesat e regjistruara në shtyllën 6 të kësaj pjese E të listës së bashkëngjitur, anëtari i bashkësisë familjare të bartësit të

ndjerë të së drejtës pronësore është përfaqësuar nga personi i autorizuar fizik i cili posedon autorizim. Komisioni përcakton se në secilën nga këto raste personi i autorizuar fizik posedon autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm nga anëtar i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore sipas nenit 5.2 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet në secilën nga këto raste. Në Kërkesën nr. 27554, prona e kërkuar është rrugë private. Ndonëse kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e kërkesave të këtij Paraqitësi të kërkesës, apo në ndihmën ligjore në dispozicion për Paraqitësin e kërkesës, natyra e pronës mund të merret parasysh kur të ekzekutohet urdhri i Komisionit për dëbim.

17. Llojet e ndryshme të dokumenteve në të cilat mbështeten Paraqitësit e kërkesave si përkrahje të kërkesave të cilat përmenden në paragrafët 12, 13, 14, 15 dhe 16 të mësipërm, janë të regjistruara në shtyllat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur.

18. Në një numër të kërkesave paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, janë larguar nga prona jashtë periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, e cila parashihet në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar se, ndonëse data e largimit në këto kërkesa është jashtë periudhës së mësipërme, humbja e së drejtës pronësore në secilin rast është rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, siç parashihet me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

19. Në Kërkesat Nr. 34015, 45279, 21960, 21965, 47905, 47907 dhe 21891 (të regjistruara në shtyllën 5 të listës së bashkëngjitur), Paraqitësit e kërkesave kërkojnë konfirmimin e të drejtës së tyre të pronësisë mbi pronat e kërkuara pa urdhër për dëbim pasi që i është dhënë leje për të shfrytëzuar pronën e kërkuar një personi të caktuar. Në këto rrethana, urdhri i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, qëndron të aprovohet, pa ndonjë formë tjetër të ndihmës juridike, siç është dhënë më sipër.

20. Duke pasur parasysh të mësipërmen, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon, se:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka pasur të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo të pjesës së tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është e pakontestuar në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) secila kërkesë në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

B. Kërkesat për kompensim

21. Në kërkesat e regjistruara në pjesën F të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përpos pronësisë, kompensim për dëmtim fizik, apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligjit Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka jurisdiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të refuzohen.


C. Vërejtje përmbledhëse

22. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe urdhri, sa i përket secilës kërkesë, të jepet siç është dhënë më sipër.

23. Në një numër kërkesash, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për riposedit të pronës së njëjtë edhe në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore, e cila kërkesë pastaj ishte aprovuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC"). Komisioni konstaton se mjetet e veprimit në dispozicion të paraqitësve të kërkesave para Komisionit aktual dhe HPCC-së, respektivisht, dhe, rrjedhimisht edhe jurisdiksioni i dy Komisioneve, nuk janë të njëjta në kuptimin se, ndryshe nga HPCC-ja, Komisioni aktual ka jurisdiksion për të konfirmuar pronësinë. Rrjedhimisht, vendimet e HPCC-së nuk mund të përbëjnë *res judicata* para Komisionit aktual. Për më tepër, në rastet kur HPCC-ja ka aprovuar urdhrin për dëbim në favor të Paraqitësit të kërkesës, Komisioni nuk konsideron se një urdhër i tillë paraqet pengesë për këtë Komision që të lëshojë urdhër të ri për dëbim në rastet kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

24. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohet, ku është e përshtatshme, edhe në çdo pronë të bashkuar *d.m.th.* çdo ndërtesa apo ndërtime të tjera të zotëruara apo shfrytëzuara nga paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

25. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 siç është miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parasheh që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA36235	KPA36236	KPA36237	KPA37872	KPA49021	KPA50269	KPA52668
KPA52669	KPA53824	KPA54010	KPA54013	KPA54019	KPA54020	KPA06263
KPA06264	KPA06270	KPA23120	KPA23121	KPA27127	KPA28022	KPA28024
KPA28025	KPA28027	KPA28028	KPA28031	KPA38242	KPA38243	KPA38352
KPA39235	KPA43166	KPA46181	KPA46184	KPA46185	KPA06268	KPA11064
KPA16303	KPA23117	KPA26222	KPA33539	KPA39225	KPA40648	KPA40653
KPA41486	KPA42323	KPA42325	KPA43165	KPA43304	KPA46183	KPA49066
KPA49069	KPA49450	KPA49455	KPA26224	KPA26225	KPA26226	KPA26227
KPA26228	KPA26229	KPA37881	KPA38167	KPA41301	KPA42321	KPA42322
KPA43258	KPA43305	KPA43307	KPA43308	KPA44401	KPA49452	KPA49454
KPA49457	KPA49458	KPA11236	KPA11237	KPA23170	KPA23171	KPA27067
KPA30508	KPA33014	KPA34533	KPA36426	KPA41006	KPA41007	KPA41008
KPA42170	KPA43040	KPA43301	KPA46160	KPA50252	KPA50885	KPA50892
KPA50893	KPA11239	KPA11246	KPA26260	KPA34519	KPA42061	KPA42063
KPA42064	KPA43164	KPA46158	KPA49070	KPA49426	KPA49427	KPA49429
KPA50246	KPA50250	KPA53911	KPA53915	KPA56466	KPA56472	KPA56476
KPA21178	KPA26259	KPA31617	KPA39226	KPA39227	KPA39228	KPA39229
KPA39230	KPA39231	KPA39233	KPA39234	KPA46038	KPA47616	KPA47617
